
STATUTI I

I

SHOQERISE “SIA INTERNATIONAL” SH.P.K.

KAPITULLI I

EMERTIMI - FORMIMI - SELIA - KOHEZGJATJA - OBJEKTI - ORTAKET

Neni 1 – EMERTIMI

Emri i shoqerise eshte “SIA International”, i ndjekur nga shtojca “SH.P.K”, qe perfaqeson formen juridike te saj, te ciles ketej e tutje do i referohemi shkurtimisht si “Shoqeria”.

Neni 2 - FORMA

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar regjistrohet ne baze te Ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, dhe ushtron veprimtarine e saj ne baze te Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat themeluese.

NENI 3 – SELIA

Zyra qendrore e Shoqerise eshte ne “Rruga e Bogdanëve, Nd.19, H.1, Ap.4, Njësia Administrative Nr.10, Tiranë” Shoqeria, me vendim te Asamblese mund te zhvendose zyren e saj qendrore ose te krijojë nje seli operative ne nje vendndodhje tjeter ne Republikën e Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi brenda apo jashte Republikës se Shqiperise, me miratim paraprak me ane te vendimit te Keshillit te Administrimit, si dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 4 - KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pacaktuar.

NENI 5 - OBJEKTI

5.1 Shoqëria do të ushtroje kryesisht aktivitetin e mëposhtem:

- Prodhim, tregtim me shumicë dhe pakicë, eksport-import i materialeve të industrisë së çeliqueve siç është dhe pa u kufizuar vetëm me to: aliazhet metalike, derdhjet metalike, konstruksionet e çelikut, profilet me saldim dhe të petëzuara, tubat me saldim dhe pa saldim, elementet e tjere të konstruksioneve metalike etj.
- Prodhim, tregtim me shumice dhe pakice, eksport-import, punime sipërfaqësore dhe/ose nëntokësore të produkteve minerare që përdoren si lende hyrëse në industrinë metalurgjike.
- Grumbullim e tregtim skrapit metalike, tregtim mallrash me shumicë e pakicë, import eksport të tyre;
- Tregtim materiale ndërtimi, tregtim hekuri, çimento, tulle etj.;
- Grumbullim, demolim, përpunim, tregtim, import eksport të mbetjeve metalike përfshirë skrap çeliku, skrape të metaleve me ngjyra, alumini, bakër, inoks, bronxi etj.;
- Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale, ushqimore, konfeksione, elektroshtëpiake, karburante e lubrifikante, lëndë të para për industrinë e ndërtimit dhe industrinë mekanike;
- Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit;
- Import Eksport të pajisjeve hidrokarburesh, pajisje pompash gazi, pajisje për stacione pompash, shitjen dhe blerjen e tyre me shumicë dhe pakicë, t'i prodhojë, t'i menaxhojë, furnizim apo shpërndarje e tyre, t'i blejë apo t' përdorë për të tjerët, si dhe mbajtjen e tyre pranë magazinave të saj, fason etj., si dhe marketimi i këtyre prodhimeve ndaj të tretëve dhe me të tretët si dhe hapjen e agjencive përkatëse për shërbime të tilla;
- Import Eksport të materialeve elektrike, t'i menaxhojë, furnizim apo shpërndarje e tyre, t'i blejë apo t' përdorë për të tjerët, si dhe mbajtjen e tyre pranë magazinave të saj, fason etj., si dhe marketimi i këtyre prodhimeve ndaj të tretëve dhe me të tretët si dhe hapjen e agjencive përkatëse për shërbime të tilla;
- Import Eksport të materialeve ndërtimore, t'i menaxhojë, furnizim apo shpërndarje e tyre, t'i blejë apo t' përdorë për të tjerët, si dhe mbajtjen e tyre pranë magazinave të saj, fason etj., si dhe marketimi i këtyre prodhimeve ndaj të tretëve dhe me të tretët si dhe hapjen e perfaqësive përkatëse për shërbime të tilla;
- Tregtim me pakicë të karburanteve, duke hapur dhe stacione të shitjes me pakicë të karburanteve;
- Kryerje veprimtarie tregtare të çdo lloji, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi në fushën e energjisë;
- Kryerje veprimtarie tregtare në fushën e peshkimit, blerje apo shitjeve të produkteve ushqimore detare, etj
- Agjenci udhëtimesh turistike, shitje biletash për transport detar, tokësor dhe ajror, organizimi i udhëtimeve turistike me anë të transportit detar, tokësor apo ajror, etj.
- Agjenci për shpërndarjen e informacionit, librave, mallrave të ndryshëm me pakicë, biletave të transportit detar, tokësor dhe ajror, on-line.

- Import Eksport të pajisjeve të veshjeve sportive, apo prodhimeve tekstile, shitjen dhe blerjen e tyre me shumicë dhe pakicë, t'i prodhojë, t'i menaxhojë, furnizim apo shpërndarje e tyre , t'i blejë apo t'i përdorë për të tjerët, si dhe mbajtjen e tyre pranë magazinave të saj, fason etj., si dhe marketimi i këtyre prodhimeve ndaj të tretëve dhe me të tretët si dhe hapjen e agjencive përkatëse për shërbime të tilla;
- Import Eksport të produkteve ushqimore apo blegtorale, t'i menaxhojë, furnizim apo shpërndarje e tyre , t'i blejë apo t' përdorë për të tjerët, si dhe mbajtjen e tyre pranë magazinave të saj, fason etj., si dhe marketimi i këtyre prodhimeve ndaj të tretëve dhe me të tretët si dhe hapjen e agjencive përkatëse për shërbime të tilla;
- Shoqëria mund te kryeje për përmbushjen e qëllimeve te saj çdo lloj operacioni tregtar, mund te veje pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, ta hipotekojë këtë pasuri ne regjistrin e pasurive te paluajtshme në emër te saj;
- Hapje hotelesh dhe restorantesh e bar bufe, supermerkato, transport i mallrave dhe i udhëtareve brenda dhe jashtë territori të Republikës së Shqipërisë.
- Hapje agjencie turistike, factoring dhe leasing në fushën e promovimit të aktiviteteve tregun e objekteve të ndërtuara si dhe sektorëve të tjerë që lidhen me objektin e veprimtarisë (Agjenci turistike, immobilare etj.)
- Kryerjen e aktiviteteve të ndryshme tregtare në fushën e hotelerisë dhe / ose turizmit, ngritjen e ndërtimin e objekteve për këtë qëllim;
- Mund te hyje ne tratativa dhe biznese me shoqëri te tjera qe kane te njëjtin objekt veprimtarie për te realizuar fitime ne fushën e aktivitetit të saj;
- Import-Eksport, prodhim, transport e tregtim për të tretët me materialin e vet ose te porositësit;
- Shoqëria mund të kryejë për përmbushjen e qëllimeve të saj çdo lloj operacioni tregtar, mund të vejë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, t'a hipotekojë këtë pasuri në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të saj.
- Mund të hyje në tratativa dhe biznese me shoqëri te tjera që kanë të njëjtin objekt veprimtarie për të realizuar fitime në fushën e aktivitetit të saj;
- Import-Eksport, prodhim, transport e tregtim për të tretët me materialin e vet ose të porositësit;
- Të marrë pjesë në ankande apo prokurime publike të zhvilluara nga organet përkatëse shtetërore sipas legjislacionit shqiptar në fuqi

5.2 Gjithashtu Shoqëria mund te marre pjese ne sipermarrje te tjera, te bashkepuoje ose te krijoje shoqëri te perbashketa me shoqëri te tjera per te operuar ne kete fushe, te bleje shoqëri, te krijoje dege brenda dhe jashte vendi, si dhe te ushtroje cdo aktivitet tjeter tregtar per sa kohe qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin Shqiptar.





NENI 6 - ORTAKET

6.1 Ortakët e Shoqërise janë:

- **Z. Andi Hoxha**, i datelindjes: 03.04.1982 lindur ne Tirane, me numer karte identiteti I20403070R, banues ne Tirane, Rr. e Durrësit, P.11, Shk. 2, Ap. 16.

- **Z. Indrit Peshkëpia**, i datelindjes: 11.07.1975, lindur ne Kruje, me numer karte identiteti H50711060P, banues ne Tirane, Rruga Hime Kolli, P.17 Njesia bashkiake 10.

- **Z. Simone Carbone**, i datelindjes: 04.08.1960, lindur ne Apice, Benevento, Itali, me numer pasaporte: YA5742596, banues në Caravaggio, 68, 80126 Napoli, Itali.

Ortaket do te kontribuojne ne kapitalin e Shoqërise dhe si rezultat do te zoterojne aksione dhe ushtrojne kontroll ne Shoqëri ne raportet e percaktuara ne nenin 6 me poshte.

KAPITULLI II

KAPITALI DHE KUOTAT

NENI 7 – KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjete mijë) lekë i formuar nga ortakët themelues me pjeset si me poshte, me vlere nominale 10'000 leke.

NENI - 8

Kuotat dhe pjesëmarrja ne kapitalin themeltar te shoqërise janë:

- 25 % (njezet e pese përqind) ose 25 pjese në pronesi te Ortakut Z. Andi Hoxha
- 25% (njezet e pese përqind) ose 25 pjese ne pronesi te Ortakut Z. Indrit Peshkëpia
- 50% (pesedhjet përqind) ose 50 pjese ne pronesi te Ortakut Z. Simone Carbone

NENI - 9

Ortaket mund te vendosin te rrisin kapitalin e shoqërise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te ortakeve. Detyrimet e ortakut kundrejt shoqërise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaket nuk do te kete asnje pergjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqërise.



NENI - 10

Shoqëria "SIA International" SHPK për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretet, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortaket e kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasurinë e tyre që nuk është futur në kapitalin e kësaj shoqërie.

Pjesëmarrja në këto shoqëri nuk i pengon ortaket të këne pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

Neni 11 - KALIMI I KUOTAVE

Pjesët shoqërore të ortakeve përputhen me pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nepermjet :

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes së kuotave
- c) trashëgimise
- d) dhurimit
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

Pjesët e tij, anëtari i shoqërisë mund t'ua ofrojë të tretëve, të cilët nuk janë anetare në shoqëri. Në rast se ortaku i cili ka vendosur të transferojë apo shesë kuotat e tij, duhet të drejtojë një kërkesë me shkrim Organit Administrativ duke saktësuar cmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zoterimi i kuotës nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit.

Shoqëria regjistron kalimin e kuotave sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KAPITULLI III ASAMBLEJA

NENI - 11

11.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

11.2 Drejtimi i asamblese, sipas sistemit të administrimit i takon administratorit të shoqërisë.

NENI - 12

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

NENI – 13

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Organi administrativ është i detyruar të therrase pa vonese asamblet e ortakëve, sa here që aq ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar e kërkojnë, ose sa here që vete organi administrativ e cileson të nevojshme.

NENI – 14

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI - 15

15.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 70 për qind të kuotave.

15.2 Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës.

15.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut, për çështjet e tjera asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

KAPITULLI IV

ADMINISTRIMI

NENI - 16

Administrator i vetem i Shoqërisë do te jetë z. Andi Hoxha , shtetas shqiptar, i datëlindjes 03.04.1982, identifikuar me ID I20403070R, me afat 5-vjecar.

Nenshkrimi i administratorit do te konfirmohet nga vula e shoqërisë e cila do te permbaje inicialet e shoqërisë.

Ne te ardhmen shoqëria mund te administrohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve, nga dy administratore qe veprojne bashkarisht ose me vete.

NENI - 17

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, pervec tjetersimit te pronave te paluatshme te shoqërisë;

b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare ne te gjitha raportet me te tretet;

c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të cilesuar te ortakeve te cilet te zoterojne shumicen e kuotave.

KAPITULLI V
BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI – 18

Veprimtarite ekonomike te shoqerise mbyllen ne 31 Dhjetor te çdo viti.

Ne fund te afatit te çdo veprimtarie ekonomike organi administrativ, brenda tre muajve duhet te procedoje ne pergatitjet e bilancit te shoqerise.

KAPITULLI VI
SHUARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI – 19

Raste te prishjes se shoqerise jane:

a) Kalimi i afatit.

b) Pamundesia per ta arritur qellimin.

c) Pamundesia e funksionimit ose vazhdimi inaktiv i asamblese;

d) Rastet e tjera te parashikuara ne ligj qe kane te bejne me ndryshimin e shoqerise ne nje forme tjeter per shkak te zvogelimit te kapitalit ne nje vlere me te vogel se ajo e percaktuar si vlere minimale per kapitalet e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar, ose qe kane te bejne me zgjidhjen e parakohshme per shkak te humbjes se gjysmes se kapitalit themeltar.

NENI – 20

Vendosja ne likuidim e shoqerise percaktohet nga mbledhja e asamblese se ortakeve, e cila kontrollon dhe miraton perfundimisht procedurat e likuidimit dhe mbylljen e shoqerise. Me emerimin e likuidatorit ose te likuidatoreve pushojne funksionet e organit administrativ. Likuiduesi ose likuiduesit, emerohen me vendim me shumice te thjeshte te asamblese se ortakeve.

KAPITULLI VII
DISPOZITA TE TJERA

NENI – 21

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjete ushtimit te aktivitetit te shoqerise do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten kompetent eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.



Regullator gjithashtu do jete ligji perkates per shoqerite tregtare.

NENI – 22

Per ato qe nuk jane shprehur ne kete statut do te behet referim me dispozitat e ligjit ne fuqi.

Ky statut eshte hartuar ne 3 (tre) kopje origjinale ne shqip dhe ne italisht (perkthyer nga perkthyes i licensuar nga ministria e drejtesise).



Ne rast mosperputhje midis dy versioneve, do te mbizoteroje versioni ne gjuhen Shqipe.

ORTAKET THEMELUES


Andi Hoxha


Andi Hoxha

Indrit Peshkepja

Simone Carbone


Simone Carbone

Tiranë më 09.08.2021